



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Mbledhja nr. **04/2025**

Data: **13 janar, 2025. Ora: 15:00**

Vendi: **Selia e KQZ**

Kryesues i KQZ-së: Kreshnik Radoniqi.

Anëtarët e KQZ-së: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ilir Gashi, Sami Hamiti,
Alban Krasniqi, Ibrahim Selmanaj, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Qemailj

Në takim ishin të Kurtis, Mufera Shinik

pranishëm:

U.D. Drejtori i SKQZ dhe Drejtor i ZRCKFSP: Besnik Buzhala

Përkthyes: Jehona Cami

Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi

RENDI I DITËS

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së

2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 01/2025

3. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ

3.1. Raport për aktivitetet e Sekretariatit të KQZ

4. Aktivitetet e Zyrës

4. 1. Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve të subjektit politik të certifikuar PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOYES - PDK_Grupi I;

4. 2. Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve të subjektit politik të certifikuar LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOYES - LDK_Grupi I;

4.3. Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve të subjektit politik të certifikuar Koalicija Vakati_Grupi I;

4.4. Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve të subjektit politik të certifikuar NOVA DEMOKRATSKA STRANKA_Grupi I

5. Këshillat e KQZ

5.1. Këshilli për Operacione Zgjedhore

5.1.1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Operacional të Sigurisë, për zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës të datës 09 shkurt 2025

5.1.2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekipeve të autorizuara për tërheqjen e dërgesave postare jashtë Kosovës

5.1.3. Njoftim lidhur me ecurinë e programit për vëzhgimin e zgjedhjeve nga TMZ-të dhe organizatat e specializuara në fushën zgjedhore

5.1.4. Diskutim për QKN dhe QV

5.2. Këshilli për Buxhet dhe Financa

6. Të ndryshme

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Kryetari **Radoniqi**, paraqiti agjendën. Lidhur me rendin e ditës, z. Elshani kërkoi të largohet pika lidhur me planin e sigurisë, diskutimi për QNK dhe QV, pika mbi tërheqjen e dërgesave postare jashtë Kosovës të shndërrohet vetëm si raportim, dhe e fundit, pika lidhur me vëzhgimin të jetë vetëm si njoftim. Besnik Buzhala, kërkoi që pika nga Buxheti dhe Financat të hiqet në tërësi, sepse është e lidhur me KOZ-in.

Me 10 vota për, miratohet rendi i ditës me propozimet për ndryshimet e bëra nga z. Elshani, dhe z. Buzhala.

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes nr. 01/2025.

Procesverbali u miratua me 9 vota për, dhe një abstenim nga z. Kurteshi.

2. Aktivitetet e Sekretariatit të KQZ

Besnik Buzhala: Më 9 janar, ka filluar votimi përmes postës. Çdo votuesi, i është dërguar njoftimet e personalizuar për fazën që lidhet me votimin përmes postës. Gjithsej, më 9 dhe 10 janar, janë dërguar njoftime për: 84,509 votues. Ndër aktivitetet e tjera, është trajnimi i trajnerëve të rekrutuar në Sekretariat. Realizohet nga data: 11 -14 janar. Më 4 janar, ka filluar periudha e aplikimit të personave me nevoja të veçanta. Deri më 12 janar, janë parashtruar 6 aplikime. Tri kërkesa janë aprovuar, tri janë refuzuar.

Zyra, është përgjegjëse lidhur me fushatën, ajo ka filluar më 11 janar. Këtë ditë, Zyra ka përcjellë fushatën e LDK-së, Lëvizja Vetëvendosje dhe PDK-së. Të dielën, më 12 janar ka monitoruar tubimin e koalicionit: AAK, Nisma dhe Intelektualët.

Sami Kurteshi: Lidhur me imelat e personalizuar për ata që do të votojnë me postë. Unë, them që ka njerëz që mund të thonë se nuk mund të shkoj më 8 shkurt të votoj në përfaqësi diplomatike fizikisht, por duan të votojnë me postë. Mund të jetë numër i madh, e nuk mund të votojnë. A munden...?

Besnik Buzhala: Të gjithë ata që kanë aplikuar dhe janë aprovuar sukseshëm, po, me automatizëm ata e kanë dëftesën e regjistrimit. Ajo vlen, pavarësisht. Kushdo që tenton me votue dy herë, KQZ i ka të gjitha mundësitë që në procesin e vlerësimit, me i identifikue.

Diskutuan: Arianit Elshani, i cili pyeti nëse do të ketë monitorim edhe më tej, edhe në komunitat e tjera. Besnik Buzhala, tha se po, do të kemi për çdo komunë nga një monitorues. Alban Krasniqi, i cili ndër të tjera tha se është platforma elektronike që personat me nevojë të veçanta mund të aplikojnë, çka nuk ka genë në të kaluarën. Pra, regjistrimi mund të bëhet edhe nga shtëpia...

Ilir Gashi, tha se nuk duhet të rrezikojmë që votuesit të informohen gabim. Në bazë të ligjit, qytetarët përcaktohen si votojnë, kur munden me tërheqë mënyrën për aplikim për votim! Në momentet e fundi, për shembull dikush vendos një ditë para ditës së votimit të mos shkoj fizikisht në përfaqësi diplomatike, atëherë, unë kam dilemat. Unë, kërkoj që ligji të bëhet i qartë, informimi, dhe të mos bëhen gabime...

Qemal Kurtis, pyeti rreth aprovimit të tri kërkesave të personave me nevojë të veçanta, ndërsa tri jo. Pse, nuk janë aprovuar këto tri...?

Besnik Buzhala, tha se arsyet e refuzimit janë se nuk i kanë bashkangjitur dokumentet e identifikimit.

Ibrahim Selmanaj, tha se jo të gjitha institucionet tona kanë qasje racionale ndaj personave me nevojë të veçanta. Pra, ne duhet të rrisim komunikimin me komunitat. Shoqëria jonë, duhet të krijoj kushte më të mira, jo vetëm kur ka zgjedhje...

3. Aktivitetet e Zyrës

Besnik Buzhala: Nga Zyra, sot kemi përgatitur 4 rekomandime për akreditim të vëzhguesve:

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve të subjektit politik të certifikuar PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVES – PDK, ka aplikuar për akreditimin e nëntëdhjetë e pesë (95) vëzhguesve.

Me 10 vota për, akreditohen.

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve të subjektit politik të certifikuar LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVES – LDK, ka aplikuar për akreditimin e njëmijë e shtatëqind e njëzetë e pesë (1725) vëzhguesve.

Me 10 vota për, akreditohen.

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve të subjektit politik të certifikuar Koalicija Vakrat, ka aplikuar për akreditimin e 234 vëzhguesve.

Me 10 vota për, akreditohej.

Rekomandim për akreditimin e vëzhguesve të subjektit politik të certifikuar NOVA DEMOKRATSKA STRANKA, ka aplikuar për akreditimin e 220 vëzhguesve.

Me 10 vota për, akreditohej.

Diskutuan: Sami Kurteshi, Arianit Elshani, Ibrahim Selmanaj, Alban Krasniqi. Të gjithë këta diskutues, u pajtuan të zgjatet afati për aplikim të akreditimit të vëzhguesve. Kreshnik Radoniqi, tha se afati është ligjorë dhe, unë nuk jam për ta shtyrë...

4. Këshillat KQZ-së

Këshilli për Operacione Zgjedhore

Shqyrtimi dhe miratimi i ekipeve të autorizuara për tërheqjen e dërgesave postare jashtë Kosovës:

Arianit Elshani: Vetëm si njoftim lidhur me KOZ-in. Kemi shqyrtuar një kërkesë për miratimin e ekipeve të autorizuara për tërheqjen e dërgesave postare jashtë Kosovës. Siç e kemi planifikuar, bëhet fjalë për 22 vende ku janë hapur kutitë postare. Kemi pranuar edhe nominimet e ekipeve nga MPJ që do të autorizohen për tërheqjen e dërgesave postare, dhe dërgimi i tyre përmes postës së shpejtë në Kosovë. Kemi disa kritere, në disa vende me nga 2, diku 3, e si në Gjermani për shembull, me 4 zyrtarë. Jemi në pritje, edhe të emrave të të nominuarve, plotësim dhe pastaj ta sjellim në KQZ komplet raportin e ekipeve.

Po ashtu, tha z. Elshani, se është pranuar një program për pritjen e vëzhguesve ndërkombëtarë. Më 7, 8 dhe 9 shkurt, do të jetë e mundur që vëzhguesit të shohin nga afër QV-të, QKN-të QNR-n. Ka konfirmime të organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare për vëzhgim...

Të ndryshme!